



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 39, date 25.9.2020**

**PËR ZHVENDOSJE OBJEKTI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 25.9.2020, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ligjit nr.8743/2001 ”Për pronat e palujtshme të shtetit”, i ndryshuar, ligjit nr.8744/2001 ”Për transferimin e pronave të palujtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendor”, VKM nr.366, datë 27.3.2008 ”Për miratimin e listës paraprake të pronave të palujtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër të Qarkut Shkodër”, rregullores ”Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër, me propozim të një grupi këshilltarësh, me 34 vota Pro,

**V E N D O S I**

1. Të zhvendoset objekti (ConTemporary), me vendndodhje në pedonale, nga pedonalja e qytetit të Shkodrës e cila referuar shkresës nr.2715/1, datë 17.2.2020, shërben në kuadrin e projektit ”Shkodra Tourist Official Brand&Shop”, financuar nga Bashkia Shkodër në partneritet me Programin Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Pernendimor (ReLOad) dhe zbatuar nga Mandarina Project, për në zona të tjera të Bashkisë Shkodër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Sekretar i këshillit**

  
**Denis Llesha**

